



Të nderuar prindër,

arsimi është gjëja më e rëndësishme, që fëmijës Tuaj i duhet për një jetë të mirë në Gjermani. Prandaj, me këtë shkresë po ju dërgojmë informatat më të rëndësishme përsa i përket mundësive të arsimimit në landin tonë Rheinland-Pfalz.

Në Rheinland-Pfalz arsimi fillon që në kopshtin e fëmijëve – një fjalë tjetër për kopsht fëmijësh, që ne në Gjermani e përdorim edhe më shpesh, është „Kindertagesstätte“, pra kopsht ditor me drekë. Fëmija Juaj në kopshtin ditor mund të luajë më fëmijët e tjerë dhe të gjejë aty shoqe dhe shokë të rinj. Dhe para së gjithash: Aty e mëson gjuhën gjermane. Fëmijët, sidomos duke luajtur bashkërisht, i mësojnë shumë shpejt gjuhët e huaja. Për këtë, kjo është një shans i madh nëse fëmija Juaj e viziton një kopsht ditor sa më parë të jetë e mundshme. Në Rheinland-Pfalz çdo fëmijë e ka të drejtën e garantuar për të vizituar kopshtin ditor, sapo të ketë mbushur moshën një vjeç. D.m.th.: Nëse e dëshironi një gjë të tillë, fëmija Juaj me siguri e fiton një vend në kopshtin ditor – dhe në momentin që mbush dy vjet biles edhe pa pagesë.

Në kopshtin ditor mund të bisedoni për gjithçka dhe detajisht me edukatoret. Përveç kësaj, fëmijën Tuaj Ju mund ta shoqëroni atje në javët e para, për të parë se si po i pëlqen. Për ne në Gjermani kjo është shumë e rëndësishme, që Ju si prindër të keni besim ndaj edukatoreve dhe të keni bashkëpunim me to. Andaj, gjithëmonë mund ti përballni ato me pyetjet Tuaja.

Vizita e kopshtit ditor për më të rinjtë është pra hapi i parë në atdheun e tyre të ri. Fëmijët më të rritur në Gjermani e vizitojnë shkollën.

Të mësuarit e zellshëm, arsimimi i mirë dhe një mbarim i mirë i shkollës janë parakushtet që të ne Gjermani të keni një jetë të mirë dhe të gjeni punë, dhe ngaqë arsimi është kaq i rëndësishëm, në Gjermani kemi edhe detyrimin për të vizituar shkollën. Kjo d.m.th.: edhe në landin tonë, në Rheinland-Pfalz është e parashikuar me ligj, që çdo fëmijë të vizitojë shkollën (neni 56 Ligji mbi shkollën).

Që fëmija Juaj të jetë i sukseshëm në shkollë, duhet ta mësojë shpejt gjuhën gjermane. Për këtë, shkollat në Rheinland-Pfalz ofrojnë edhe kurse intensive. Në këto kurse jepen deri në 20 orë mësim të gjuhës gjermane në javë. Krahas mësimin të

gjuhës gjermane fëmija Juaj që nga fillimi mëson bashkërisht me shoqe dhe shokë klase gjermanë. Në lëndët, për të cilat nuk duhen patjetër menjëherë njohuritë e gjuhës gjermane, fëmija Juaj në këtë mënyrë mund të lidhë kontakte me fëmijët gjermanë të së njëjtës moshë dhe mund të krijojë shoqëri të reja. Lëndë të tilla p. sh. janë arti figurativ, muzika, sporti dhe – nëse fëmija Juaj e flet anglishtën – gjuha angleze.

Një shkolleje të mirë i duhet besimi si dhe bashkëpunimi i prindërve, kuadrit mësimdhënës si dhe nxënësve. Në shkollë më tej Ju mund të gjeni edhe informacione përsa i përket mundësive të arsimit në shtetin tonë. Pra, mundeni dhe do të duhej t' i drejtoheni me pyetjet Tuaja në çdo kohë kuadrit mësimdhënës si dhe drejtoreshës apo drejtorit të shkollës së fëmijës Tuaj.

Ju dëshirojmë gjithë të mirat në Gjermani si dhe fëmijës Tuaj shumë kënaqësi në kopshtin ditor dhe shumë suksese në shkollë.



Irene Alt

Ministre shteti për integrim,
familje, fëmijë, rini dhe gra



Vera Reiß

Ministre shteti për arsim,
shkencë, kualifikim dhe kulturë